

VENDIM
Nr. 266, datë 10.4.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 531, DATË 7.9.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE
SHTETËRORE ‘OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA’ SHA, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT, NË EMËR DHE
PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 13/4 shtohen pikat 13/5 dhe 13/6, me këtë përmbajtje:

“13/5. Për procedurat e prokurimit, që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit për sistemet, pajisjet *software* dhe *hardware*, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., në cilësinë e organit qendror blerës, kryen edhe përlllogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vlerë, e cila konfirmohet respektivisht nga autoriteti ose enti kontraktor përkatës.

13/6. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 47, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, zhvillohet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor.”.

2. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. dhe të gjitha autoritetet kontraktore, subjekt i zbatimit të këtij vendimi, për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama